



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 24.03.2025

Numër Protokoli: 1958 /2025

A.nr.217/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.217/2025, të datës 27.01.2025, të parashtruar nga ankuesja M.B, të cilin me autorizim e përfaqëson avokat Valdrin Islami nga Mitrovica, kundër organit: Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5, nenin 16 paragrafin 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 24.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.217/2025, të datës 27.01.2025, të parashtruar nga ankueses M.B.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil, M.B (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja*), përmes postës më datë 22.01.2025, ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është pranuar më datë 27.01.2025, kundër Njoftimit të datës 27.12.2024, të Divizionit të Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, për shpalljen e rezultateve përfundimtare lidhur me konkursin me numër Reference: RN00015583, për grupin e administrimit të përgjithshëm për pozitën *Zyrtar i Skemave Pensionale*, i shpallur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë përmbushur kushtet për përfundim të procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.217/2025, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se MFPT, më datë 23.10.2024 ka shpallur konkursin me numër reference RN00015583, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm pozitë

Zyrtar i Skemave Pensionale, në Departamentin e Pensioneve në Mitrovicë, katër (4) pozita, kategoria profesional 2, ku afati për aplikim ka qenë nga data 24.10.2024 deri më 22.11.2024.

Tutje sipas shkresave të lëndës, në këtë konkurs kanë aplikuar 213 kandidatë mesin e tyre edhe ankuesja, dhe sipas njoftimit të datës 12.12.2024 për verifikim paraprak janë përfshirë 95 kandidat që i kanë plotësuar kushtet e konkursit në mesin e tyre edhe ankuesja, ndërsa pas përfundimit të fazave të vlerësimit, Divizioni i Burimeve Njerëzore i MFPT-së, më datë 27.12.2024, ka publikuar njoftimin për kandidatët fitues me katër kandidatë: D. Q me 96.8 pikë, B.A me 93.8 me pikë, S.Xh-R me 93.4 pikë dhe N.K me 88.4 pikë.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 27.12.2024, të Divizionit të Burimeve Njerëzore të MFPT-së, për shpalljen e kandidatit fitues, pretendon se përbërja e komisionit ka qenë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi; vlerësimi nga komisioni i pranimit nuk ka qenë objektiv. Kërkon që ankesa të aprovohet ndërsa të anulohet njoftimin për përfundimin e procedurës dhe procedura të kthehet në fazën e rishqyrtimit të testimit.

Bazuar në të dhënat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rezulton se kandidatja për pranim në procedurën me numër të referencës RN00015583, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm pozitë Zyrtar i Skemave Pensionale, në Departamentin e Pensioneve në Mitrovicë, A.R-A kishte parashtruar ankesë në Këshill më datë 24.01.2025, kundër procedurës së njëjtë të pranimit, ndërsa, Këshilli me Vendimin A.nr.199/2025, ka aprovuar ankesën e palës ankueses, ndërsa procedurën e pranimit të cekur si më lartë e ka kthyer në fazën e verifikimit paraprak, ashtu që Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, është obliguar të ndërmarr veprimet për vazhdimin e procedurës së pranimit nga faza e verifikimit paraprak.

Andaj, referuar gjendjes së fakteve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.217/2025, të datës 27.01.2025, ka të bëjë me procedurën e pranimit për të cilën Këshilli ka vendosur me Vendimin A.nr.199/2025, rrjedhimisht, meqenëse ankuesja me ankesën A.nr.217/2025, konteston këtë procedurë, e duke qenë së Këshilli më Vendimin A.nr.199/2025, ka aprovuar ankesën e palës ankueses duke e kthyer këtë procedurë të rekrutimit në fazën e verifikimit paraprak, atëherë, mbi bazën e këtyre rrethanave rrjedhë së objekti i ankesës A.nr.217/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot”*.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar me ankesën A.nr.217/2025, të datës 27.01.2025.

Këshillë juridike: *Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë*

(30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.217/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankueses Avokat Valdrin Islami;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në MFPT; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.